



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.10/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, kryetarja e gjykatës, Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore parashtruar nga ana e ankuesit A.M., nga Prizreni, ndaj gjyqtarës E.S., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren në Departamentin e Përgjithshëm- Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit të lartcekur sipas lëndës C.nr.945/20 (124/09), në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.08.05.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankuesit (të paditurit) A.M., nga Prizreni, ndaj gjyqtarës E.S., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës A.M., nga Prizreni, në ankesën e tij ka cekur se ka vërejtje ndaj gjyqtarës E.S., për shkak të lëndës C.nr.945/20 (124/09), ku i njëjti është palë e paditur së bashku me R.M., Q.M., dhe F.M., kurse pala paditëse është A.M.,. Objekt kontesti është vërtetim i pronësisë. Ankuesi (A.M.,) ka cekur se gjyqtarja ka bërë shkelje flagrante të LPK —së dhe ka qenë e njëanshme në trajtimin e lëndëve të cilat ai i ka pasur në këtë gjykatë dhe atë në lëndët C.nr.124/09 tani C.nr.945/20, C.nr.78/11 dhe lëndën C.nr.426/15 tani 2079/19, ku i njëjti ka qenë palë së bashku me djalën e tij K.M., dhe në të cilat lëndë ka vendosur kjo gjyqtare. A.M., pranë kësaj gjykate në vitin 2020 ka parashtruar kërkesë për përjashtim tek UD Kryetari i gjykatës për gjyqtaren E.S., në lëndën C.nr.945/20 (124/09). UD Kryetari i gjykatës ka vendosur me ADGJTHPZ.nr. 1/2020-141 me dt.29.12.2020 për këtë kërkesë duke e refuzuar si të pabazuar. Më pas i njëjti ka kërkuar përjashtimin e U.D., Kryetarit të gjykatës në Gjykatën e Apelit në Prishtinë ku Gjykata e Apelit , respektivisht Kryetari i Gjykatës së Apelit ka vendosur me Aktvendim të cilin Aktvendim CN.nr.113/21 nuk e ka pranuar në kohën kur është vendosur, por e ka pranuar me dt. 31.03.2023 nga ana e shkrimores së zyrës civile pas kërkesës së tij. Sipas ankuesit gjyqtarja e ka mbajtur të fshehur këtë aktvendim në mënyrë që të humb afatin për ankesë ndaj këtij aktvendimi pasi që Kryetari i Gjykatës së Apelit ka refuzuar kërkesën për përjashtim të UD Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren.

Ankuesi në këtë lëndë ka parashtruar sërish kërkesë për përjashtim të gjyqtarës në këtë çështje me dt. 03.04.2023 dhe gjyqtarja ka vendosur në kundërshtim të nenin 70.1 të LPK-së pasi që sipas dispozitës së cekur për përjashtim vendos Kryetari i gjykatës dhe jo gjyqtari. Konsideron se gjyqtarja ndaj atyre si palë vazhdimisht ka pasur gjykim të njëanshëm në të gjitha lëndët të cilat

kanë qenë palë ankuesi dhe familja e tij (C.nr.78/2011, C.nr.2079/19, C.nr.945/2020) dhe për këtë duhet të ndërmerren masa disiplinore në të kundërtën do të detyrohen që ata të marrin vetveten në mbrojtje.

Gjyqtarja E.S., në deklaratën e saj ka cekur se në lidhje me lëndën C.nr.78/2011 dhe Aktvendimin e dt. 25.10.2013 pala paditëse ka qenë K.M., kurse pala e paditur Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës në Prizren për themelim të marrëdhënies së punës. Në këtë çështje është caktuar seanca përgatitorë me dt. 25.10.2013 në të cilën pala paditëse nuk ka prezantuar në seancë edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë dhe gjyqtarja ka marr aktvendim me të cilën padia konsiderohet e tërhequr. Pala paditëse nuk është ankuar edhe pse ka pasur udhëzim juridik për ankesë. Gjyqtarja ka cekur se nuk ka pasur njohuri se kush është paditësi K.M., dhe për të është me rëndësi veprimi i saj sipas dispozitave ligjore dhe vendosja sipas ligjit. Në lëndën civile C.nr.2079/19 (426) pala paditëse ka qenë A.M., kundër të paditurës IPKO Prishtinë për largim të rrjetit dhe për pagesë të qirasë mujore. Gjyqtarja ka vendosur në këtë çështje dhe lënda sipas ankesës është kthyer në rigjykim dhe ka marr numrin C.nr.2079/19. Sipas këtij numri gjyqtarja ka vendosur me Aktgjykim dhe lënda sipas ankesës nga dt. 16.08.2022 është pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Edhe sipas kësaj lënde gjyqtarja ka cekur se nuk e ka njohur as paditësin e as familjarët e tij por se ka vendosur sipas ligjit dhe i është mundësuar edhe e drejta në ankesë të cilën të drejtë e ka shfrytëzuar pala paditëse.

Sipas lëndës C.nr.945/2020 (124/2009) padia është iniciuar nga ana e paditësit A.M., nga Prizreni, kundër të paditurit A.M., Q.M., R.M., për vërtetim të së drejtës së pronësisë. Me aktgjykim C,r.124/2009 të dt. 13.07.2015 është aprovuar kërkesëpafia e paditësit të cilin aktgjykim e kanë ankuar të paditurit dhe Gjykata e Apelit e ka kthyer në rigjykim ku lënda tani evidentohet C.nr.945/2020 dhe është në procedurë e sipër ku me dt. 31.03.2023 është caktuar seanca përfundimtare. Dy ditë para se të mbahet kjo seancë i padituri A.M., ka kërkuar nga gjyqtarja të gjitha procesverbalet e seancave të mbajtura dhe me dt. 31.03.2023 ka kërkuar përjashtim të gjyqtarës për të dytën herë nga kjo çështje. Gjyqtarja në kuptim të nenit 69 par.1 pika 1 të LPK-së dhe nenit 69 par.2 të LPK-së dhe nenit 69 par.3 të LPK-së ka vendosur me aktvendim C.nr.945/2020 me dt. 03.04.2023.Gjyqtarja ka cekur se ka vepruar me paanshmëri dhe bazuar në dispozita ligjore me qëllim të vërtetimit dhe ndarjen e drejtësisë në mënyrë ligjore dhe jo me ndonjë qëllim tjetër për të gjitha çështjet e ankimuara.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes E.S., ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës C.nr.945/20 (124/09), C.nr.78/11 dhe lëndën C.nr.426/15 tani 2079/19 dhe pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme Autoriteti Kompetent konsideron se

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ka pasur bazë për Shkelje disiplinore pasi që pretendimet e ankuesit A.M., janë të pa vërtetuara dhe të paprovuara. Respektivisht Sipas lëndës C.nr.78/11 ku si paditës është i biri i A.M., K.M., e njëjta çështje ka përfunduar me Aktvendim ku padia konsiderohet e tërhequr pasi që paditësi K.M., i ftuar në mënyrë të rregullt nuk është paraqi A.M., tur në seancë, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe pala e paditur nuk ka parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancës dhe gjyqtarja në kuptim të nenit 410 të LPK dhe në lidhje me nenin 387 të LPK ka vendosur sipas ligjit. Me shikimin në shkresa të lëndës është vërtetuar se ftesën për seancë e ka pranuar pala paditëse K.M., i cili nuk është paraqitur në shqyrtim dhe gjyqtarja me të drejtë ka vepruar sipas ligjit. I njëjti ka pasur të drejtë në ankesë të cilën të drejtë nuk e ka shfrytëzuar. Sa i përket lëndës C.nr.2079/19 e njëjta është sipas ankesës në

Gjykatën e Apelit në Prishtinë dhe për këtë çështje është duke u vendosur nga ana e Gjykatës së Apelit sipas ankesës së paditësit A.M.,.

Në lidhje me lëndën C.nr.945/2020 me numër të vjetër C.nr.124/2009 gjyqtarja në këtë lëndë ka vendosur lidhur me përjashtim të saj me aktvendim C.nr.945/2020 me dt. 03.04.2023 pasi që ankuesi A.M., ka kërkuar përjashtimin e gjyqtares për herë të dytë dhe kompetenca për vendosje në këtë rast i takon gjyqtares në kuptim të nenit 69 par. 1 pika 1 të LPK-së dhe nenit 69 par.2 të LPK-së dhe në rastin konkret gjyqtarja me të drejtë e ka zbatuar këtë dispozitë të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Në lidhje me pretendimet e ankuesit se i është mohuar e drejta në ankesë sipas nenit 69 par.3 të LPK —së ndaj këtij Aktvendimi nuk është e paraparë e drejta në ankesë të veçantë, andaj edhe gjyqtarja ka vendosur në pajtim me këtë dispozitë. Sa i përket çështjes së vendosjes dhe zhvillimit të tërësishëm të procedurës është në diskrecion të gjyqtares se si do të vendos dhe cilat prova do të administron. Për këtë kemi edhe mjetet e rregullta të ankimit (të drejtën e ankesës) dhe mjetet tjera të cilat ankuesi mund ti shfrytëzojë dhe lënda të vendoset nga gjykata e shkallës më të lartë të cilën të drejtë palët mund ti shfrytëzojnë dhe ti shprehin pakënaqësitë e tyre.

Për arsyet që u cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.10/2023, me dt. 08.05.2023



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e paraparë e drejta e ankesës.